




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS - SHITIME
Komiteti për Politikë dhe Financa
Nr.01-060/01-17276/22 datë: 01.07.2022



Npi – 01/229 datë: 05.07.2022

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi-01/114 të datës: 26.04.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 05.07.2022 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -IV- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 05.07.2022 (e martë) në ora 9:00 h. në sallën e Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi: z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrushî, znj.Adelina Beqaj znj.Sanije Sadiki, (znj.Heroina Selmani, on-line). Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar, z.Shpëtim Gashi, zyrtar për informim, znj. Valmira Hoxha, praktikante. Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Propozim-Vendim për ndrrimin e destinimit të paluajtshmërisë Nr.1836-0, Z.K-Pjetërshticë,
2. Shqyrtimi i Raportit Financiar të Komunës për Periudhën Janar – Qershor 2022,

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Përparim Ramusa; Përshëndetje, pajtohem me rendin e ditës.

znj.Sanije Sadiki; Përshëndetje, edhe ne pajtohemi me rendin e ditës.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht aprovoi rendin e ditës.**

Pika I

Propozim-Vendim për ndrrimin e destinimit të paluajtshmërisë Nr.1836-0, Z.K-Pjetërshticë
Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Lexoi, Propozim-Vendimin për ndrrimin e destinimit të paluajtshmërisë Nr.1836-0 nga DPUKGJ-ja, dhe hapi diskutimin.
z.Lumni Amrushî; Po dua me dhënë një sqarim, e kam një hartë përpara por që nuk po shihet bash mirë. Ju jeni ra pre e kërkesës të palës Avni Dugolli, po flas politikisht. Duke dhënë disa sqarime mbi bazën e hartës, tha: Ai e ka për qëllim që me e mbyllë këtë rrugë, duke treguar me hartën që e mbante në dorë. Unë jam për me ja leju varrezat por për mos me u mbyllë rruga prej 6 metrave gjerësi. Unë jam kundër veq për arsye të rrugës.

z.Kadri Emini; Unë pajtohem me sqarimin që e dha Idajeti, se kemi të bëjmë me Propozim-Vendimin e DPUKGJ-së e jo me kërkesën e palës, tani ne duhet të vendosim ajo që është në interes të përgjithshëm, e jo individual.

znj.Adelina Beqaj; E di që ka qenë kërkesë e një qytetari, por tani ne duhet të vendosim në bazë të propozimit të drejtorisë. Unë nuk jamë për me e mbyllë rrugën, jam për me kalu ky vendim por jo me mbyllë rrugën.

z.Përparim Ramusa; Dha sqarime Idajeti, por edhe Lumni Amrushi, ne faktikisht jemi para një akti të kryer për shkak të varrezave që i kanë aty, kjo familje. Unë propozoj që sasia e pronës aty të ndahet për gjysëm dmth. 14 ari varreza dhe 14 ari rrugë. Thash se jemi pak a shumë para aktit të kryer sepse ne realisht nuk bënë të krijojmë raste presedane. Ne jemi që rruga mos me u mbyllë.

z.Lumni Amrushi; Unë propozoj që fillimisht me u zgjidhë çështja e rrugës aty dhe mos me u lënë më pak se 6 metra, prandaj unë po propozoj që kjo me u shty dhe me u nda ashtu qysh e lyp rruga për me u rregulluar mirë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi Kuorumin prej 7 anëtarëve të Komitetit prezent në mbledhje.

* Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e Vendimit për ndrrimin e destinimit të paluajtshmërisë Nr.1836-0, Z.K-Pjetërshticë, për varreza të fshatit Pjetërshticë – Lagja Dugolli, me vërejtjen që në këtë parcelë prej 28 ari të mbetet rruga e hapur me gjerësi mbi 6 metra, ndërsa pjesa tjetër të destinohet për varreza, sa i përket pjesës teknike të rregullimit të pikave dhe regjistrimin e paluajtshmërisë në librat kadastral për destinimin e rrugës ta kryej DPUKGJ-ja.

Pika 2

Shqyrtimi i Raportit Financiar të Komunës për Periudhën Janar – Qershor 2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiar; Përshëndetje, Dokumentin e keni marrë me kohë dhe po besoj që e keni lexuar. Në vazhdim e lexoi raportin në pikat kryesore (shih dokumentin). Unë nuk do ta zgjati më shumë por nëse ka ndonjë pyetje do të përgjigjem, Ju ftoj që ti rekomandoni Kuvendit aprovimin e këtijë raporti.

znj.Adelina Beqaj; Unë jamë që të na e sqaroni pak më në detaje, sepse kohë kemi dhe nuk kemi pika të tjera.

z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiar; Në vazhdim pra raportin do ta prezantojë pak më detaishtë, sipas kategorive dhe kodeve buxhetore ashtu qyshë u kërkua nga Adelina. Këto shifra që po i shihni për tatimin në pronë dhe sektoret të tjera janë shifra të cilat janë prezantuar në raport si shpenzime të realizuara, në krahasim me periudhën e njejtë të vitit të kaluar (në vazhdim i lexoi nga dokumentiu me shifra), Sa i përket huamarrjes deri në këtë periudhë janë shpenzuar 139,521.38€ në raport me parat që i kemi pas në dispozicion i kemi realizuar mbi 38%.

z.Përparim Ramusa; Faleminderit për elaborimin, unë nuk kamë pas kohë me e lexuar, prandaj unë nuk kam rekomandim për këtë pikë. Te shpenzimet duhet me i analizuar pak më mirë. Unë nuk jam as për një rekomandim e as për jo, spse përveq sqarimeve që i dha Bujari, siq e thashë unë nuk e kam lexuar dokumentin. Te huamarrja, a kryhet komplet buxheti i planifikuar me këtë vit apo jo, fjala pra është për kredinë e ndërtimit të kolektorit për trajtimin e ujërave të zeza.

z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiar; Unë do ta kërkojë një raport nga DPUKGJ-ja se deri ku ka shkuar puna në teren. Unë e kamë për detyrë me e nënshkruar raportin dhe me e dërguar. Deri në muajin Qershorë i kemi pas mjetet, por nuk kemi informatë nga Ministria se po mbyllet. Pagesat kryhen sipas kryerjes së punëve në teren. Kjo ndikon në performancën e Komunës, për me fitu grantin.

znj.Adelina Beqaj; Po shkojmë pa rekomandim, ta shohim edhe një herë raportin.


z.Kadri Emini; Si raport është i saktë, kështu që unë jamë për me i rekomandu Kuvendit për me kalu.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi Kuorumin prej 6 anëtarëve të Komitetit prezent në mbledhje.

* **Komiteti për Politikë dhe Financa, me 3 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 3 vota “Abstenim” vendosi që t’i rekomandoi Kuvendit miratimin e Raportit Financiar të Komunës për Periudhën Janar – Qershor 2022.**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 10:10h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i KPF
Adnan Ademi

